



Bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionalizimin e qendrave mësimore (tutje në tekst: UA) të aprovuar nga Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë më datën 7 Dhjetor 2018;

Në përputhje me Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, e cila prezanton vazhdimësinë e politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e të cilat shërbejnë për fuqizimin karakterit multi-etnicitet dhe multi-kulturalizëm në shoqërinë kosovare;

Në përputhje me Deklaratën e Poznanit të nënshkruar së fundmi nga partnerët e Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së, në të cilin kryeministrat e Ballkanit Perëndimor ritheksojnë angazhimin e tyre për integrimin e Romëve në shoqëritë tona, si dhe zotohen të rrisin përpjekjet e tyre si pjesë e procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe bashkëpunimit rajonal; dhe

Në përputhje me përpjekjet e vazhdueshme të Komunës së Vushtrrisë për të përkrahur integrimin e komuniteteve rom dhe ashkali të përcaktuar në Planin e veprimit lokal të komunës së Vushtrrisë, arrihet kjo:

ANEKS I I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT në mes të

OJQ - Terre des hommes Kosovë, përfaqësuar nga znj. Florina Duli Sefaj, Drejtoreshë për Kosovë (referuar më poshtë si “TdH”) dhe

Komuna e Vushtrrisë e përfaqësuar nga z. Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës (referuar më poshtë si “Komuna”),

Neni 1

Në bazë të Nenint 2.2 të Marrëveshjes bazë si dhe Nenit 3.2 të së njejtës marrëveshje, Komuna e Vushtrrisë ofron këto të dhëna për palën tjetër:

Llogaria bankare (e dhënë e shtypur në fletë të vecantë)

Personeli që angazhohet në qendër:

Dhurata Fazliu- gjuhë shqipe

Lindita Bala – Fakulteti i Edukimit programi fillor

Emine Sadiku – Bachelor i Pedagogjisë së Përgjithshme

Albinë Popova – Bachelor i përkujdesjes sociale dhe mirëqenie e fëmijëve

Valmire Krasniqi Lahu – Master i Arteve Gjuhë Angleze

Neni 2
Hyrja në Fuqi

2.1 Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e përfaqësuesve të autorizuar të palëve.

2.2 Kjo marrëveshje është hartuar në 2 (dy) kopje identike, nga 1 (një) për secilën palë.

Palët nënshkruese

Komuna e Vushtrrisë

Terre des hommes

__/__/2021

Xhafer Tahiri,
Kryetar i Komunës



__/__/2021

32

Florina Sefaj
Drejtoreshë për Kosovë

